



Merr Pjesë dhe Ndrysho Komunitetin tënd!

Vizitoni platformën e-Democracia për të kontribuar në buxhetimin me pjesëmarrje dhe për të përmirësuar shërbimet publike për qytetarët!



Kjo fletëpalosje në kuadër të projektit "Inovacion në Buxhetim: Pjesëmarrja e Qytetarëve si Motor i Zhvillimit Lokal" me mbështetjen nga skema e granteve "BAT Civil Society", e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në partneritet me Faktoje dhe Center for Research and Policy Making (CRPM), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.



Pjesëmarrja Qytetare në Hartimin e Buxheteve Lokale

Në një shoqëri demokratike, buxheti nuk duhet të jetë një proces i mbyllur dhe i kufizuar vetëm për administratën publike. ky proces i duhet të reflektojë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve.


Përmes pjesëmarrjes aktive në hartimin e buxheteve lokale, komuniteti mund të ndikojë drejtpërdrejt në mënyrën se si shpenzohen paratë për shërbime dhe investime të reja.



Përdorimi i Teknologjisë drejt Përfshirjes Aktive

Përdorimi i platformave digjitale e bën më të lehtë për qytetarët që të marrin pjesë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje.

Teknologjia e bën më të thjeshtë për çdo qytetar që të përfshihet, pa pasur nevojë të jetë fizikisht prezent në takime ose në zyra publike.



Vendimmarrja përmes Teknologjisë

Përdorimi i platformave digjitale në vendimmarrje, sjell:

- **Qasje të lehtë dhe të shpejtë:** Informohuni në kohë reale mbi projektet dhe buxhetet lokale.
- **Mundësi për sugjerime dhe votime:** Çdo qytetar ka mundësinë të kontribuojë me idetë e veta.
- **Forcim i komunitetit:** Teknologjia sjell qytetarët së bashku në një proces demokratik të hapur.